



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 73.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L – 040, nenit 3. 1 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/10 dhe të nenit 45.2 të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2012, miratoi këtë:

### **VENDIM PËR NGRITJEN E KOMITETEVE KONSULTATIVE**

#### **Neni 1**

Ngriten Komitetet konsultative, si vijojnë:

- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komiteti për Mbrojtje të Ambientit dhe Mjedisit
- Komiteti për Barazi Gjinore dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Fëmijëve

#### **Neni 2**

Kuvendi nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJQ-ve, në propozim të Kolegjit përzgjedhës, ngritë përbërjen e Komiteteve të cekuar në nenin 1 të këtij vendimi.

Komitetet përbëhen nga 7 anëtarë

Komitetet nga përbërja e tyre e zgjedhin kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

#### **Neni 3**

Komitetet konsultative, në lëmi përkatëse, bëjnë hulumtime, japin propozime dhe ofrojnë vlerësime lidhur me iniciativat e Ekzekutivit dhe Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 4**

Përzgjedhja e anëtarëve të Komiteteve bëhet përmes procedurës së konkursit publik.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Nr. 01/145 - 02**  
**Podujevë,**  
**10 korrik 2012**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hazir Raçi**